

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR



Për *Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Rr. Ibrahim Rugova, Nr. 4, Tiranë 1007*

### I. Informacion i Përgjithshëm

Bazuar në Kontratën nr. Prot. 2336, datë 09/05/2022 lidhur me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në cilësinë e Ekspertit Kontabël të Liçensuar (Auditues Ligjor) me misionin e auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzimeve për vitin kalendarik 2021 për **Partia Republikane Shqiptare**. Si vijon, po ju paraqes raportin e hartuar sipas formatit të standartizuar nga KQZ-ja.

### II. Informacion Ligjor

#### i. *Kuadri Ligjor*

Refruar kontratës së shërbimit, auditimi ligjor i raporteve financiare vjetore të partive politike kërkohet dhe realizohet në zbatim të kërkesave ligjore si vijon:

- Ligji Nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
- Udhëzimi Nr. 10, datë 21.04.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për caktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, dhe mënyrën e pagesës së audituesve".

Nga pikëpamja profesionale kryerja e auditimit ligjor bazohet në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të) të miratuara dhe të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe të Dhënies së Sigurisë të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK), të detyrueshme për zbatim nga ligji për auditimin e sipërcituar.

#### ii. *Standartet e kontabilitetit të zbatueshme*

Në përputhje me Ligjin, Nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", partitë politike kanë statusin e njëjësive jofitimprurëse dhe janë subjekt i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të) dhe specifikisht i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jofitimprurëse (SKK për OJF-të).

Sipas këtij Ligji, Njësitë ekonomike jofitimprurëse (OJF) hartojnë pasqyrat financiare si më poshtë:

- a) pasqyrën e pozicionit financiar;
- b) pasqyrën e aktiviteteve;
- c) pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare;
- ç) shënimet shpjeguese.

### III. Objekti i Auditimit

#### i. Kontrata e shërbimit

Për përmbushjen e misionit të auditimit, me palën angazhuese KQZ-në, u lidh kontrata e shërbimit Nr. Prot. 2336, datë 09/05/2022, me objekt: "Kryerja e auditimit të detyrueshëm të partive politike, të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë periudhës raportuese 2021, në përputhje me Ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar dhe ligjeve të tjera respektive cituar sa më sipër si dhe Kontrata me Partinë Republikane Shqiptare më datë 8 Qershor 2022.

#### ii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor

##### *Përgjegjësitë e drejtimit të Partisë Politike*

Auditimi do të kryhet bazuar në faktin që drejtimi (personi përgjegjës për regjistrimin dhe kontrollin e aktivitetit financiar të partisë politike ose personi i përcaktuar sipas statutit të partisë) pranon dhe kupton se ka përgjegjësi:

- a) Për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare (raportit vjetor) në pajtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jo-Fitimprurëse (SKK për OJF-të) dhe me kërkesat specifike të Ligjit "Për Partitë Politike" i ndryshuar, dhe në udhëzimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së);
- b) Për kontrollin e brendshme të atilla që drejtimi i partisë i konsideron të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale nga mashtrimi apo gabimi; dhe
- c) T'i ofrojë audituesit:
  - Të drejtën e hyrjes në të gjitha informacionet për të cilat drejtimi ka dijeni se janë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare, sic janë regjistrimet, dokumentacioni dhe çështje të tjera;
  - Informacion shtesë, të cilin audituesi mund ta kërkojë nga drejtimi për qëllime të auditimit; dhe
  - Të drejtën e komunikimit pa kufizim me personat brenda partisë nga të cilët audituesi e gjeton të nevojshme për të marrë evidencë auditimi.

Si pjesë përbërëse e procesit të auditimit, do të kërkohen nga drejtimi i partisë dhe, kur të jetë e përshtatshme, edhe nga personat e ngarkuar me administrimin që të merren prej tyre konfirmime me shkrim lidhur me deklaratimet me gojë që do të bëhen në lidhje me auditimin.

### *Përgjegjësitë e Audituesit*

Auditimi do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Këto standarde kërkojnë që të respektohen kërkesat etike. Si pjesë e një auditimi sipas SNA-ve, do të ushtroj gjykimin profesional dhe do të ruaj skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.

Objektivat janë që të arrihet një siguri e arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare (raporti vjetor financiar), në tërësi, nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshohet një raport auditimi që përfshin opinionin tim. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë vendimet e përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Gjithashtu kam dhe përgjegjësi të tjera raportuese, që burojnë nga termat e kontratës, për të vlerësuar përputhshmërinë e veprimeve ekonomike dhe financiare, që lidhen me kërkesat specifike të Ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për Partitë Politike", i ndryshuar dhe udhëzimet e KQZ-së, me burimet e financimit, procedurat e marrjes së donacioneve jopublike, dokumentimit dhe regjistrimit të tyre, identifikimin e dhuruesve, publikimin e tyre, etj.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve dhe anomalive materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit që lidhet me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare për të planifikuar procedura të përshtatshme auditimi për rrethanat përkatëse, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Prandaj, ne nuk shprehim një opinion të tillë. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

## **IV. Informacion mbi Subjektin Politik**

### *i. Prezantimi i subjektit politik*

Partia Republikane Shqiptare është regjistruar pranë Gjykatës së Shkalles së Parë me urdher nr. 16/2 datë 10.01.1991 të Ministrisë së Drejtësisë, me veprimtari Parti politike në përputhje me Ligjin nr.8580 datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar.

Partia Republikane Shqiptare ushtron veprimtarinë e saj me seli të regjistruar në adresën: Rruga "Abdi Toptani", ish Hotel "Drini", kati 3-të, Tiranë.

Partia Republikane Shqiptare si person juridik, është e regjistruar në sistemin tatimor me NIPT K52428003L dhe ka kryer deklaratimet e duhura sipas përgjegjësive tatimore dhe aktivitetit që ajo ka kryer. Gjithashtu, ajo ka plotësuar detyrimin ndaj KQZ-së për dorëzimin e Raportit financiar vjetor 2021.

## ii. Forma e organizimit dhe menaxhimit të Partisë

Sipas statutit struktura e organizimit dhe e drejtimit të Partia Republikane Shqiptare përbëhet nga:

### Organet Qendrore

- Kongresi i Partisë
- Asambleja Kombëtare
- Kryetari i Partisë
- Kryesia e Partisë
- Komiteti Drejtues i Partisë

Strukturat vendore janë të ngritura dhe funksionojnë në të gjitha qarqet, por nuk kanë zyra dhe ambiente fikse, në pronësi, përdorim apo me qera dhe nuk kanë funksione administrimi në burimet dhe përdorimet e fondeve të partisë. Kryerja e funksioneve të drejtimit politik dhe funksioneve të tjera ndihmëse bazohet kryesisht në punën vullnetare të anëtarëve të saj. Por, për realizimin me sukses të aktiviteteve financiare nga donatori, në subjektin Partia Republikane Shqiptare ka një të punësuar me kohë të plotë pune.

Veprimtaria ekonomike e partisë administrohet nga Kryetari i Partisë, i cili kontrollon burimet dhe përdorimin e fondeve financiare në funksion të aktiviteteve të dhe qëllimeve të partisë, si dhe shqyrton raportet financiare para dorëzimit të tyre në organet kompetente shtetërore dhe të partisë.

Sistemi i kontabilitetit është i organizuar në selinë qendrore të partisë. Degët në qarqe nuk kanë detyra administrimi. Sipas deklarimeve të partisë nuk ka organizata që kanë lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë siç mund të jenë fondacionet, organizatat e rinisë, etj.

## V. Prezantimi i Raportit Financiar Vjetor dhe Struktura e tij

### i. Struktura e raportit— kërkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet

Struktura e Raportit financiar vjetor (Pasqyrat financiare) të Partisë Republikane Shqiptare, të vëna në dispozicion tonin dhe dorëzuar pranë KQZ-së përbëhet nga Raporti i Të Ardhurave dhe Shpenzimeve 2021 (fondet e përfituara dhe shpenzuara).

### ii. Takimet dhe komunikimet midis audituesit dhe subjektit zgjedhor dhe çdo personi tjetër të tretë

Menjëherë pas firmosjes së kontratës me KQZ-në janë vendosur kontaktet me personin që merret me administrimin e partisë dhe deklarimet financiare, kryefinancierja, znj. Suela Kokoshi. U nënshkrua kontrata me Kryetarin e Partisë, z. Fatmir Mediu, kontratë në të cilën u përcaktuan termat e angazhimit dhe përgjegjësitë reciproke të palëve. Në vijim u ofruan të dhënat financiare për vitin 2021 si dhe informacioni lidhur me aktivitetin e Partisë, të cilat janë firmosur nga kryefinancierja e Partisë.

### iii. Paraqitje e përgjithshme e raportit vjetor të partisë politike, përputhshmëria e tij me kërkesat e raportimit

Kam vlerësuar paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e raportit financiar vjetor (pasqyrave e të ardhurave dhe shpenzimeve), përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna për vitin 2021, nëse ato paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrën që të japin paraqitjen e drejtë.

Raporti financiar vjetor, i paraqitur dhe publikuar në KQZ, është hartuar sipas SKK-ve, sipas formës së pasqyrave të kërkuara prej SKK-së për OJF-të.

## VI. Kërkesat Formale të Raportit Vjetor

### A. Përmbledhje

<b>1. Data e Dorëzimit të Raportit Vjetor</b>			
	Dorëzimi fizik	Po	Datë 27.03.2022
<b>2. Nënshkrimi</b>			
	Nënshkrimi	Po	Datë 27.03.2022
	Identiteti i nënshkruesit	Po	Suela Kokoshi-Kryefinanciere

### B. Informacion mbi Partinë, Audituesin dhe Llogaritë bankare

<b>1. Informacioni për Partinë politike</b>	
Emri i Partisë politike	Partia Republikane Shqiptare
Adresa e selisë	Rr. "Abdi Toptani", ish Hotel "Drini", kati i 3-të
Adresë e-maili	suelakokoshi@gmail.com
Numër telefoni	Nuk ka
<b>2. Informacion për audituesin ligjor</b>	
Emri i Audituesit ligjor	Elton Tirana
Adresa e Audituesit	Rr. Medar Shtylla, Kompleksi Kika 1, Nd. 47, H.23
Adresë e-maili	elton.tirana@studiotirana.com
Numër telefoni	0699325722
<b>3. Të dhënat e Llogarisë Bankare të Partisë Politike</b>	
Emri i bankës ku mbahet llogaria	Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a
Numri i Llogarisë bankare	ALL – 2029031802
	ALL – 2029038601
	ALL – 2029031801
Emrat dhe nënshkrimi i të gjithë personave të autorizuar për veprimet tek llogaria bankare	Suela Kokoshi - kryefinanciere

### C. Aktivet dhe Detyrimet

<b>1. Kriteret e klasifikimit të aktiveve</b>	
<u>Përshkrimi i natyrës së secilit aktiv, pronë e partisë, në datën e vlerësimit:</u> Sipas natyrës, aktivet në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, 31.12.2021 përbëhen: - Mjete monetare në arkë dhe në bankë	
<u>Vlerat e tregut të aktivitetit, në datën e vlerësimit nëse është bërë vlerësim, ose vlerën kontabël të mbetur:</u>	
- Mjete monetare në arkë dhe e bankë 31.12.2021.	
Llogaria bankare pranë Intesa SanPaolo Bank 2029031802 .....	(1,817.88) Lekë
Llogaria bankare pranë Intesa SanPaolo Bank 2029038601 .....	5,360.05 Lekë
Llogaria bankare pranë Intesa SanPaolo Bank 2029031801 .....	59,582.70 Lekë
Mjete monetare në Arkë .....	1,880.4 Lekë
Shuma mjete monetare	65,005 Lekë

## 2. Kriteret e klasifikimit të detyrimeve

<u>Përshkrimi i llojit të secilit detyrim të partisë, në datën e vlerësimit:</u>	
Sipas llojit, detyrimet në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, 31.12.2021 përbëhen:	
- Detyrime për furnizime të ndryshme	
- Detyrime për Paga	
- Furnitorë për mallra e shërbime	
Top Channel Sh.a (fatura nr. 09239729, datë 22.06.2013) .....	9,140,000 Lekë
Media 6 (TV Klan) Sh.a (faturë nr. 09616220, datë 30.09.2013) .....	2,000,000 Lekë
Paga të pagueshme (Qershor-Tetor 2021) .....	173,770 Lekë

## D. Përmbledhje Financiare

Përmbledhje Financiare	
Periudha e Raportimit	01 Janar 2021 – 31 Dhjetor 2021
Shuma e Mjeteve Monetare në fillim dhe në fund të periudhës së raportimit	Gjendja e Bankës në fillim: 252,332 Lekë
	Gjendja e Bankës në fund: 65,005 Lekë
Shuma e përgjithshme e të gjithë kontributeve të marra	Gjendja e Arkës në fillim: 75,987 Lekë
	Gjendja e Arkës në fund: 1,880 Lekë
Shuma e përgjithshme e të gjitha shpenzimeve të bëra	Financim për Fushatë: 3,926,232 Lekë
	Kuota Anëtarësie: 740,000 Lekë
Bilanci në fund të periudhës së raportimit	Shpenzime gjithsej: 4,929,555 Lekë
Shuma e përgjithshme e të gjithë Aktiveve në fund të periudhës së raportimit	31 Dhjetor 2021
	Aktivët më 31.12.2021: 65,005 Lekë
Shuma e përgjithshme e të gjithë Detyrimeve në fund të periudhës së raportimit	Detyrimet më 31.12.2021: 11,313,770 Lekë

### a. Vlerësimi i informacionit dokumentar mbi llogaritë bankare

Nga evidenca dokumentare që kam marrë nga drejtimi i partisë, rezulton se Partia Republikane Shqiptare disponon 3 Llogari bankare, në monedhën "Lekë", në Intesa SanPaolo Bank sh.a. Për të tre llogaritë kam marrë lëvizjet e llogarive bankare (bank statement) për të gjithë vitin financiar nga 1 janari 2021 deri më 31 Dhjetor 2021. Nga auditimi rezultoi se transaksionet janë regjistruar, klasifikuar dhe raportuar në mënyrë të rregullt dhe nuk u konstatuan gabime apo mospërputhje me kërkesat rregullatore.

### b. Vlerësimi i informacionit mbështetës të Pasqyrave Financiare

Nga evidenca e dokumentacionit mbështetës mbi të cilat janë hartuar pasqyrat financiare të Partisë Republikane Shqiptare, sipas klasifikimeve dhe llogarive, kemi siguruar të gjitha blerjet, lëvizjet bankare (Statement bankar) për të gjitha llogaritë për periudhën 1.01.2021 – 31.12.2021. Kemi siguruar dokumentacionin e deklaruar nga Partia Republikane Shqiptare në tatime, të tilla si

Listëpagesat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore, Tatimi në Burim, mjetet monetare/financimet (statement bankare dhe dokumentet e arkës). Kam shqyrtuar të gjithë dokumentet e siguruara (pasi ato ishin relativisht të pakta në numër), nëse ishin plota, pasqyrojnë transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura gjatë periudhës dhe a i përkasin subjektit. Nga verifikimi, nuk u konstatua ndonjë parregullsi domethënëse nga shqyrtimi formal i tyre.

#### E. Të Ardhurat

##### i. Përmbledhje

Lloji i Financimit	Shuma në Lekë
Financim Vjetor i Buxhetit për vitin 2021	0
Financim nga Ministria e Financave për Fushatë	3,926,232
Kuota Anëtarësie	740,000
Interes bankar	10.71
<b>TOTAL</b>	<b>4,666,242.71</b>

Të gjitha të ardhurat e mësipërme janë dokumentuar dhe regjistruar në llogaritë e Partisë, ku u verifikuan edhe si hyrje nëpërmjet Llogarive Bankare dhe Arkës.

#### F. Shpenzimet

##### i. Përmbledhje

Natyra e Shpenzimeve	Shuma në Lekë
Shpenzime Fushate	3,907,850
Paga	209,000
Sigurime	168,360
Shpenzime për energji elektrike	89,613
Shpenzime për telefon	111,257
Shpenzime për dieta	45,000
Pagesë anëtarësimi IDU	196,416
Shpenzime Taksa vendore	16,706
Komision Bankar	11,400
Shpenzime për Internet	19,190
Shpenzime të ndryshme	154,764
<b>TOTAL</b>	<b>4,929,555</b>

Të gjitha Shpenzimet e mësipërme janë dokumentuar dhe regjistruar në llogaritë e Partisë, ku u verifikuan edhe në Llogaritë Bankare dhe të Arkës. Verifikimet e regjistrimeve të mësipërme që

lidhen me shpenzimet për ndodhjen, plotësinë, saktësinë, prerjen e periudhës dhe klasifikimin u kryen mbi bazën e vlerësimit të rrisqeve, që janë karakteristikë për aktivitetin e partive politike. Shpenzime të konsiderueshme të kryera nga Partia Republikane Shqiptare të evidentuara përfshijnë reklamim në media televizive, të tilla si Top Channel dhe TV Klan lidhur me fushatën zgjedhore dhe shpenzime të tjera të lidhura me fushatën si karburant e materiale reklamuese. Këto shpenzime janë kryer nëpërmjet faturave të rregullta tatimore, të paguara në mënyrë të rregullt nga llogaria bankare e subjektit politik në llogaritë bankare të subjekteve respektive.

## VII. Sinteza dhe Opinioni i Auditimit

### A. Sinteza

#### Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve

Përfundova procesin e auditimit bazuar në vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale, mora evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, përdora procedurat që gjykova të nevojshme dhe nuk evidentova anomalitë materiale si rezultat i gabimit, mashtrimit, përjashtime të qëllimshme apo informacione të deformuara në pasqyrat financiare 2021 të deklaruara nga Partia Republikane Shqiptare në KQZ, në të gjitha elementët, aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet.

Po ashtu u vlerësuan politikat kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi, dhe arritëm në konkluzionin se ato janë të drejta dhe të përshtatshme për aktivitetin që zhvillon një parti politike. Lidhur me kërkesat specifike të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për Partitë Politike", i ndryshuar dhe udhëzimet e KQZ-së si, burimet e financimit, procedurat e marrjes së donacioneve jopublike, burimet e lejuara, kufizimet, dokumentimit dhe të regjistrimit të tyre nuk u gjetën parregullsi dhe shkelje ligjore.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat e opinionit tonë të auditimit.

#### *Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të Auditimit*

Nga kontrolli i dokumentacionit financiar të siguruar nga Partia Republikane Shqiptare, konfirmojmë që nuk mungojnë dokumenta financiare mbështetës, duke mos sjellë në këtë mënyrë kufizim të aksesit tonë në informacionin dhe dokumentacionin financiar. Të gjitha transaksionet janë kryer konform ligjeve dhe procedurave, duke u pasqyruar saktë dhe në mënyrë transparente në llogaritë bankare të Partisë, duke shmangur rrezikun në këtë mënyrë të përjashtimeve të qëllimshme apo informacioneve të deformuara në pasqyrat financiare. Nuk konstatohen gabime materiale, në të gjithë elementet e aktivitetit, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë procesit të auditimit.

### B. Opinioni mbi Auditimin e Raportit Financiar 2021

#### Opinioni pa rezervë

Kam audituar Raportin financiar vjetor të Partisë Republikane Shqiptare, të cilat përfshijnë Pasqyrën të Ardhurave dhe Shpenzimeve, Pasqyrën e Pozicionit Financiar më datën 31 Dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Raporti financiar vjetor i Partisë Republikane Shqiptare dorëzuar pranë KQZ-së bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Partisë



Republikane Shqiptare më datën 31 Dhjetor 2021, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të).

### Baza për opinionin pa rezervë

Raporti Financiar Vjetor 2021 i dorëzuar pranë KQZ-së, është përgatitur mbi parimet dhe rregullat e përgjithshme të SKK-ve.

#### *Opinioni mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullatore*


Në përfundim të verifikimeve dhe informacioneve të marra, në referencë me kërkesat, kufizimet dhe detyrimet specifike të kërkuara prej ligjit "Për Partitë Politike", i ndryshuar dhe udhëzimeve të KQZ-së, për çështjet që gjejnë zbatim në aktivitetin e kryer për 2021, opinionin ynë është si vijon:

- Burimet e financimit të aktivitetit politik të Partisë Republikane Shqiptare për periudhën raportuese 2021, kanë ardhur nga Financimi nga Ministria e Financave sipas Shkresës nr. 6096-1, datë 08.04.2021 në mbështetje të Partive Politike që marrin pjesë në fushatë zgjedhore, si dhe nga kuotat e anëtarësisë.
- Nuk u evidentuan marrje të fondeve jopublike, në para apo në natyrë, nga dhurues të identifikuar dhe të paidentifikuar, me shuma mbi 100 mijë Lekë dhe të papublikuar.
- Nuk u evidentuan parregullsi dhe anomali materiale në zbatimin e kërkesave të Legjislacionit kontabël dhe atij tatimor, për dokumentimin, regjistrimin sipas llogarive, matjen, klasifikimin dhe deklarimin e veprimeve dhe faktet ekonomike që i përkasin partisë, të lidhura me aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet.

Tiranë, më 23 Shtator 2022

Elton Tirana

Auditues Ligjor



Njesia Jo Fitimpruese

NIPT -i

Adresa e Selise

Partia Republikane Shqiptare

K52428003L

Nr. i Vendimit te Gjykates

Data e Vendimit te Gjykates

Veprimtaria Kryesore

Rruga Abdi Toptani, Tirane

# PASQYRAT FINANCIARE

( Organizatat Jo Fitimpruese )

( Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit per OJF-te )

## Viti 2021

Pasqyra Financiare jane te shprehura ne  
Pasqyra Financiare jane te rumbullakosura ne

Leke

Leke

Periudha Kontabel e Pasqrave Financiare

Nga

01.01.2021

Deri

31.12.2021

Data e mbylljes se Pasqrave Financiare


29.03.2022

Shtojca 1

Njesia Jo Fitimprurese

Pasqyra e Pozicionit Financiar te Vitit 2021

Nr	<b>AKTIVET</b>	Periudha 2021	Periudha 2020
	Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	65,005	328,318
	Të drejta dhe interesi i arkëtueshëm	-	0
	Kontribute të arkëtueshme	-	0
	Investime financiare afat gjata	-	0
	Aktive të kufizuara për investime në toka, ndërtesa dhe pajisje	-	0
	Toka, ndërtesa dhe pajisje	-	0
	Investime të tjera afat gjata	-	0
	<b>Totali Aktiveve</b>	65,005	328,318
	<b>DETYRIMET</b>		
	Të pagueshme	11,140,000	11,140,000
	Dëftesa të pagueshme page e prapambetur	173,770	10,550
	Kontribute të marra në avancë	-	-
	Grante	-	-
	Premtime të kushtëzuara për të dhënë	-	0
	Hua afat gjatë	-	-
	<b>Totali Detyrimeve</b>	11,313,770	11,156,550
	<b>AKTIVET NETO</b>	-	-
	Të kufizuara	11,248,765	-10,828,232
	a) Tokë ose vepra arti të dhuruara për t'u përdorur për qëllime specifike me përoaktimin që të ruhen apo të mos shiten		
	b) Aktive të dhuruara me qëllimin për t'u investuar dhe siguruar prej tyre burime të përhershme të ardhurash		
	Të pakufizuara		
	<b>Totali Aktiveve Neto</b>	11,248,765	-10,828,232



*Kotasy*

## Shtojca 2

## Njesia Jo Fitimprurese

## Pasqyra e Pozicionit Financiar 31.12.2021

(Shpenzimet të paraqitura sipas funksionit)

Nr	Pershkrimi i zerit	Periudha 2021	Periudha 2020
	Ndryshimi në aktivet neto të pakufizuara:		
	<b>Te ardhurat</b>		
	Të ardhura nga tarifat e anëtarësimit		
	Të ardhura nga buxheti I shtetit	740,000	62,000
	Të ardhura nga grantet qeveritare apo nga agjenci të tjera të financimit	3,926,232	0
	Të ardhura nga investimet apo dhurimet		0
	Tarifat për shërbimet		0
	Të ardhura nga aktivitetet tregtare		0
	Të ardhura të tjera (interesa)		0
		11	11
	<b>Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara</b>	<b>4,666,243</b>	<b>52,011</b>
	<b>Aktive neto të çliruara nga kufizimet:</b>		
	Aktive neto të çliruara nga kufizimet:		
	Realizimi i kufizimeve të programit		0
	Realizimi i kufizimit për blerjen e pajisjeve		0
	Përfundimi i kufizimit të afatit		0
			0
	<b>Totali i aktiveve neto të çliruara nga kufizimet</b>		<b>0</b>
	<b>Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara:</b>		
	<b>Shpenzime për aktivitetet</b>		
	Paga		
	Sigurime	209,000	500,000
	Dieta, event dhe koktejl, anëtarësim	168,360	66,950
	Energji, Telefon, qera, Pastrim, Karburant	241,416	170,000
	Bileta avioni dhe shërbim makine, pastrim, internet, komision, taksa bashkie	200,870	600,000
	Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme	47,296	19,340
	Shpenzime fushate	154,764	1,021,152
	Krijim dhe rritje fondesh	3,907,850	
	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>4,929,556</b>	<b>2,328,442</b>
	<b>Rritja/Rënia në aktivet neto të pakufizuara (A)</b>		<b>-2,328,442</b>
	<b>Ndryshimi në aktivet neto të kufizuara:</b>		
	Kontributet		
	Të ardhurat nga investimet afat gjata		
	Fitimi i realizuar dhe i parealizuar nga investimet afatgjata		
	Humbja aktuariale nga obligacioni vjetor		
	Aktivitet neto të çliruara nga kufizimet (me shenjë minus)		
	<b>Rritja/Rënia në aktivet neto përkohësisht të kufizuara (B)</b>	<b>- 263,313</b>	<b>0</b>
	<b>Ndryshimi në aktivet neto (A + B)</b>	<b>- 263,313</b>	<b>-2,323,113</b>
	Aktive neto në fillim të vitit	328,318	2,651,431
	Aktive neto në fund të vitit	65,005	328,318

fo kashy


Shtojca 3

Njesia Jo Fitimprurese

**Pasqyra e Flukseve te Mjeteve Monetare 31.12.2021**

**Metoda Direkte**

Nr	Pershkrimi i zerave	Periudha 2021	Periudha 2020
	<b>Flukset nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>		
	Para të arkëtuara nga kontribute të pakufizuara	4,666,243	62,011
	Para të arkëtuara nga përfituesit e shërbimeve		
	Grante / pagueshëm / kthyeshëm		
	Të paguara për punonjësit dhe furnitorët	-4,929,556	-2,385,124
	Interes i paguar		
	Interes dhe dividendë të arkëtuar		
	<b>Flukse neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>	-263,313	-2,323,113
	<b>Flukset nga aktivitetet investuese</b>		
	Kontribute të kufizuara		
	Blerje/Shitje investimesh		
	Blerje/Shitje të aktiveve afatgjata materiale		
	<b>Flukse neto nga aktivitetet investuese</b>		
	<b>Flukse nga aktivitetet financuese</b>		
	Arkëtime nga kontributet e kufizuara për investime në dhurime / ndihma		
	Interesa dhe dividendë të kufizuar për qëllime në terma afatgjatë		
	Principal i paguar për dëftesat e pagueshme		
	<b>Flukse neto nga aktivitetet financuese</b>		
	Rritje / Rënie neto e flukseve	-263,313	-2,323,113
	<b>Gjendje në fillim të periudhës</b>	328,318	2,651,431
	<b>Gjendje në fund të periudhës</b>	65,005	328,318



## SHENIMET SPJEGUESE

Pasqyrat financiare per vitin 2021 jane ndertuar ne perputhje me ligjin Nr 25/2018 date 10.05.2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe aktet nenligjore ne zbatim te ketij ligji dhe te ndryshimeve perkatese. Po keshtu per plotesimin e tyre jane zbatuar kerkesat e Standarteve Kombetare e Nderkombetare te Kontabilitetit.

Partia republikane eshte nje organizate jofitimprures

Hartol pasqyrat

Suela Kokoshi

Suela Kokoshi

Suela Kokoshi

Drejtori Ekzekutiv

Fatmir Mediu



**PARTIA REPUBLIKANE SHQIPTARE  
ASAMBLEJA KOMBETARE  
KRYEFINANCIERI**

---

**Adresa : Rruga « Abdi Toptani », Ish Hotel « Drini », kati i tretë**

**Nr.6 Prot.**

**Tiranë, më 27.03.2022**

**Lënda : RAPORTI FINANCIAR VJETOR 2021**

**Drejtuar : KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE**

**TIRANE**

**Nga : Partia Republikane Shqiptare**

**Mbështetur në Vendimin Tuaj nr.3 datë 18.01.2012, po Ju parashtrojmë sipas Lidhjes 2 të këtij Vendimi Raportin Financiar Vjetor për vitin 2021.**

**1.1 Informacion i përgjithshëm:**

Partia Republikane Shqiptare është regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me urdhër nr. 16/2 datë 10.01.1991 të Ministrit të Drejtësisë.

**STRUKTURA E PR-së**

**Organet Qëndrore të Partisë janë:**

- Kongresi i Partisë
- Asambleja Kombëtare
- Kryetari i Partisë
- Kryesia e Partisë
- Komiteti Drejtues i Partisë

## 1.2 TE ARDHURAT:

Në fillim të vitit 2021 gjendja jonë financiare në bankë dhe në arkë ka qenë, 328,318 lekë (75,987 lekë në Arkë dhe 252,331 lekë në Bankë), ndërsa në fund të vitit 2021 është **65,005 lekë** ( 1,880 lekë në Arkë dhe 63,125 lekë në Bankë).

Të ardhurat tona nga Buxheti i Shtetit dhe donatorë të ndryshëm, gjatë vitit 2021 kanë qenë si më poshtë:

NR.	LLOJI I FINANCIMIT	SHUMA (në lekë)
1.	Fin. Vjetor i Buxhetit për vitin 2021	0
2.	Financim për Fushatë	3,926,232
3.	Kuota anëtarësie	740,000
4.	Interes Bankar	10.71
	<b>TOTALI (1+2+3+4)</b>	<b>4,666,242.71</b>

## 1.3 SHPENZIMET:

Shpenzimet e kryera nga Partia Republikane gjatë vitit 2021, kanë qenë të ndara në zëra si më poshtë:

NR.	LLOJI I SHPENZIMIT	SHUMA (NE LEKE)
1	Shpenzime fushate	3,907,850
2	Paga	209,000
3	Sigurime	168,360
4	Shpenzime për energji elektrike	89,613
5	Shpenzime për telefon	111,257
6	Shpenzime për dieta	45,000
7	Pagese anetaresimi IDU	196,416
8	Shpenzime taksa bashkie	16,706
9	Komision Bankar	11,400
10	Shpenzime për internet	19,190
11	Shpenzime te ndryshme	154,764
	<b>SHUMA NE TOTAL</b>	<b>4,929,555</b>



**1.4 Për vitin 2021 kemi detyrime të pa shlyera si më poshtë:**

NR	ELLOJI SHPENZIMIT	FATURA	SHUMA (në lekë)
1.	Top Channel-Spot publicitar	Fat.09239729 Datë 22.06.2013	9,140,000
2.	Media 6 (Klan)-Spot publicitar	Fat.09616220 Datë 30.09.2013	2,000,000
3.	Paga te prapambetura	Paga qershor-tetor 2021	173,770
	<b>SHUMA</b>	<b>X</b>	<b>11,313,770</b>

**Në zërin "Shpenzime të përditshme për stafin" janë përfshirë:**

- ✓ Riparim automjeti
- ✓ Pastrimi i zyrave
- ✓ Kancelari
- ✓ Blerje të ndryshme etj.

**Kryefinancjeri:**

**Suela KOKOSHI**

